



## REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

### AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Up1 Nr. 03-153

20.05.2022

Sh k u p

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në lidhje me nenin 15 paragrafi 5 nga Ligji për media („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13 dhe 13/14), pika 7 e Rregullores për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-1825/1 nga 29.04.2022 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2038/4 nga 20.05.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 20-të e mbajtur më 20.05.2022, miratoi si në vijim:

#### **Vendim për marrjen e masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET shoqëria tregtare radiodifuzive (SHTR) televizioni IRIS SHPK Shtip, për shkelje të nenit 15 paragrafi 5 nga Ligji për media, që brenda afatit të përcaktuar me ligj (31 mars 2022) nuk i dorëzoi Agjencisë raport me shkrim për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në licencën për transmetim televiziv nr. 08-902 nga 08.07.2015.

Shkelja nga neni 1 i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr. 10-1825/1 nga 29.04.2022., e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shtojcë nr.1.

2. OBLIGOHET SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, në afat kohor prej 45(dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit, të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për media.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikë 2 të këtij Vendimit, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyruar, referuar pikës 1 të këtij Vendimi, ka vepruar sipas vendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar, dhe si ditë e miratimit të tij konsiderohet dita e verifikimit në arkivin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele(Agjencisë).

#### **A r s y e t i m**

Agjencia bazuar në nenin 29 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenin 29 nga Ligji për media (LM), është kompetente të kryejë mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i pajtueshmërisë së punës së tyre me detyrimet nga nenet 6, 8, 14 dhe 15 nga LM.

Në pajtueshmëri me nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmorri masë – vendim për vërejtje publike në pajtueshmëri me këtë Ligj, në rastet e shkeljes së dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara nga po i njëjti Ligj, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në lejen dhe akteve të tjera të Agjencisë.

Në pajtueshmëri me nenin 29 paragrafi 2 nga LM, masat që Agjencia si organ kompetent rregullator mund të marrë përsipër, ku janë dhe të përcaktuar në LSHMAAV, zbatohen me përpikmëri dhe në raste të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 15 paragrafi 5 nga LM, transmetuesit obligohen ndaj organit kompetent të dorëzojë raport me shkrim, për zbatimin e detyrave të përcaktuara në lejen për transmetim në radio dhe televizion, dhe në veçanti për zbatimin e planit programor, jo më vonë se data 31 mars të vitit aktual. Si shtojcë në raport paraqitet dhe informacioni për mjetet teknike nëpërmjet të cilit transmeton ose ritransmeton shërbimet programore në Republikën e Maqedonisë ose jashtë saj.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes sektorit për çështje programore, më 28 prill 2022., konstatoi se SHTR televizion IRIS SHPK Shtip në afatin e përcaktuar ligjor (31 mars 2022) nuk dorëzoi në Agjencion raport me shkrim për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim në radio dhe televizion, veçanërisht për zbatimin e konceptit programor, si dhe informacion për mjetet teknike nëpërmjet të

cilit transmeton ose ritransmeton shërbimet programore në vend ose jashtë saj, duke mos përmbushur kështu detyrimet nga neni 15 paragrafi 5 nga Ligji për mediat.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr. 10-1825/1 nga 29.04.2022., e cila është pjesë plotësuese e këtij Vendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtueshmëri me nenin 23 paragrafi 3 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR televizionit IRIS SHPK Shtip më 03.05.2022., dërgoi Shkresë ark ynë.nr.10-1825/2 nga 03.05.2022. dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr. 10-1825/1 nga 29.04.2022., ku në afat kohor prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Shkresa është pranuar më datë 06.05.2022. Në afatin e përcaktuar, SHTR televizion IRIS SHTR Shtip nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 20.05.2022., shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi se ndaj SHTR televizion IRIS SHPK Shtip t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht sa më sipër, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, në lidhje me nenin 15 paragrafi 5 nga LM, pika 7 i Udhëzuesit për përcaktimin e afatit për zbatim të vendimit të Agjencisë për marrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen administrative të kryer ark.nr. 10-1825/1 nga 29.04.2022. dhe Konkluzionin ark.nr. 02-2038/4 nga 20.05.2022., për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LM, të përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 20.05.2022., miratoi Vendim ku publikisht paralajmërohet SHTR televizion IRIS SHPK Shtip dhe obligohet në afat kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LM. Pas Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, ka vepruar sipas Vendimit.

Në pajtueshmëri me nenin 24 nga LSHMAAV, Ky Vendim është përfundimtar dhe ndaj tij botuesi i medias (transmetuesi) mund të ngrejë padi për kontest administrativ pranë gjykatës kompetente. Padi për fillimin e kontestit administrativ paraqitet brenda 30 ditëve prej ditës së pranimit të vendimit..

Bazuar në sa më sipër, u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime  
mediatike audio dhe audiovizuale,  
Kryetar i Këshillit**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi transmetuesi mund të ngrejë padi për fillimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padi për fillimin e kontestit administrativ paraqitet brenda 30 ditëve prej ditës së pranimit të vendimit.

**Shtojca (1):**

1) Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-1825/1 nga 29.04.2022r.

**Dorëzuar tek:**

- SHTR televizion IRIS SHPK Shtip;
- Udhëheqësit të SHTR televizion IRIS SHPK Shtip;
- Personit përgjegjës të programit në SHTR televizion IRIS SHPK Shtip;
- Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik;
- Sektorit për çështje programore; dhe
- Personat e emëruar në Agjencinë për udhëheqjen e regjistrimit Up.1